REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

# BULETINI MUJOR

JANAR 2025



## TJETËR AVANCIM NË PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE PËR QYTETARËT SHQIPTARË QË JETOJNË E PUNOJNË JASHTË VENDIT

Falë marrëveshjes së nënshkruar mes Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), Ministrisë së Brendshme dhe Kompanisë "Identitek", koha e nevojshme për pajisjen me dokumente biometrikë do të reduktohet me 50%. Shkurtimi i kohës për marrjen e pasaportës nga 30 ditë në 15 ditë është një dëshmi e hapave konkretë të ndërmarrë për modernizimin dhe thjeshtimin e procedurave për shërbimet kaq të rëndësishme për qytetarët shqiptarë kudo ku ndodhen, të cilët mbeten prioriteti dhe qendra e vëmendjes së shërbimit konsullor të MEPJ.



## SHQIPËRIA MBETET E PËRKUSHTUAR NDAJ PROMOVIMIT TË BARAZISË, DINJITETIT DHE RESPEKTIT PËR TË GJITHË

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, z. Igli Hasani hapi në Tiranë Konferencën inaugurale #HR30, EMPOWER TALK: Qëndresa Kundër Urrejtjes & Përqafimi i të Drejtave", organizuar në bashkëpunim me Universitetin e Essex. Ministri Hasani nënvizoi se Shqipëria mbetet e përkushtuar ndaj promovimit të barazisë, dinjitetit dhe respektit për të gjithë, vlera thelbësore këto që i mbrojmë me krenari gjatë mandatit tonë në Këshillin e OKB-së për të Drejtat e Njeriut dhe në rrugëtimin tonë drejt BE-së. Ndër të tjera, ai u shpreh se vendi ynë qëndron i palëkundur në angazhimin e vazhdueshëm për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për të gjithë.



## SHQIPËRIA QËNDRON ME VENDOSMËRI ME UKRAINËN NË RRUGËN E SAJ DREJT PAQES, SIGURISË DHE TË ARDHMES EVROPIANE

Ministri Hasani ka zhvilluar disa takime produktive në Ukrainë me Presidentin Volodymyr Zelenskyy, Kryetarin e Parlamentit Ruslan Stefanchuk, Kryeministrin Denys Shmyhal, Zëvendëskryeministren Olga Stefanishyna dhe Ministrin e Jashtëm Andrii Sybiha. Përgjatë kësaj vizite, janë shkëmbyer instrumentet e ratifikimit të Marrëveshjes së Miqësisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet Ukrainës dhe Shqipërisë, si dhe është nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi, me fokus bashkëpunimin në integrimin evropian. Këta hapa janë dëshmi e progresit të rëndësishëm në forcimin e marrëdhënieve mes dy vendeve dhe riafirmojnë angazhimin e Shqipërisë për një partneritet të fortë dhe të qëndrueshëm.



## INAUGUROHET AMBASADA E SHQIPËRISË NË UKRAINË, HASANI: "BASHKË PËR NJË EVROPË TË FORTË"

Përgjatë vizitës së tij në Kyiv, Ministri Igli Hasani ka inauguruar Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Ukrainë, ku mori pjesë edhe homologu i tij ukrainas, Andrii Sybiha. E hapur në fund të vitit 2024, ambasada shqiptare pësoi dëme materiale si pasojë e sulmeve me raketa ruse. Gjatë ceremonisë, u theksua se kjo ambasadë është jo vetëm një urë bashkëpunimi afatgjatë mes dy vendeve, por edhe një dëshmi e qëndrueshmërisë dhe angazhimit të përbashkët për një të ardhme në paqe e progres dhe të një Evrope të bashkuar, të fortë dhe të begatë.



## SHQIPËRIA DHE UKRAINA NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJEN PËR BASHKËPUNIM NË SIGURI DHE MBËSHTETJE AFATGJATË

Davos, Zvicër – Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama dhe Presidenti i Ukrainës Volodymyr Zelenskyy kanë nënshkruar Marrëveshjen për Bashkëpunimin në Siguri dhe Mbështetje afatgjatë, e cila shënon një hap domethënës përpara në partneritetin mes dy shteteve. Kjo marrëveshje gjithëpërfshirëse ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, promovimin e interesave të përbashkëta të sigurisë dhe rritjen e aftësisë së të dyja shteteve për të adresuar sfidat globale që po shfaqen. Në një kohë kur kërcënimet për sigurinë janë gjithnjë e më komplekse dhe të përhapura, kjo marrëveshje sinjalizon një angazhim të fortë për ndërtimin e një të ardhmeje më të sigurt dhe të mbrojtur për Shqipërinë, Ukrainën dhe rajonin më të gjerë evropian.



## VITI 2025 KA NISUR MBARË ME ENTUZIAZMIN PËR TË RUAJTUR MOMENTIN E RRUGËTIMIT TË SHQIPËRISË DREJT INTEGRIMIT EVROPIAN

Negociatat janë tashmë të hapura për dy grup-kapituj të rëndësishëm. Në këtë kontekst, Ministri Hasani ka mirëpritur në Tiranë dhe ka zhvilluar diskutime të Ballkanin Perëndimor në Shërbimin Evropian të Veprimit të Jashtëm (EEAS). Gjatë takimit, z. Hasani ka nënvizuar përkushtimin e Shqipërisë për të thelluar më tej bashkëpunimin për çështje strategjike të EEAS dhe aktorë të tjerë, me qëllim kryesor avancimin e integrimit evropian të Shqipërisë.




## ABU DHABI, NËNSHKRUHET MARRËVESHJA STRATEGJIKE TREPALËSHE NË FUSHËN E ENERGJISË MES SHQIPËRISË, ITALISË DHE EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE

Në Emiratet e Bashkuara Arabe është nënshkruar marrëveshja e investimit për lidhjen nënujore të rrjetit të shpërndarjes së energjisë me Italinë në detin Adriatik, si edhe për investimet në rritjen e prodhimit nga burimet e rinovueshme në Shqipëri, ndërmjet, Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, Qeverisë së Republikës së Italisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe. Marrëveshja, e cila për palën shqiptare u nënshkrua nga Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë Belinda Balluku , – bashkon vendet në një aleancë strategjike për energjinë e rinovueshme. Më herët, gjatë fjalës së tij në Samit, Kryeministri tha se marrëveshja do të shërbejë për të rritur kapacitetin e Shqipërisë si një lojtar kyç në rajon, mbështetur në prodhimin e saj me 100% energji të ripërtëritshme.



## NËNSHKRUHET MARRËVESHJA E VENDIT PRITËS MES SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE TË INVESTIMEVE

Kjo marrëveshje u nënshkrua nga Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme Z. Igli Hasani dhe Zëvendës Presidenti i Bankës Evropiane të Investimeve (BEI) Z. Robert de Groot. Nënshkrimi i saj është një hap i rëndësishëm që ndikon në zhvillimin e shpejtë ekonomik të Shqipërisë dhe rrugën e saj drejt integrimit në BE. Sipas Ministrit Hasani, kjo është një iniciativë kyçe për të mbështetur zbatimin e Planit Ekonomik dhe të Investimeve të BE-së, si dhe Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor. Hapja e kësaj zyre synon të maksimizojë mbështetjen financiare dhe teknike për projekte të rëndësishme, projekte të cilat BEI e ka mbështetur Shqipërinë që prej vitit 1995.



## POLONI, MINISTRI HASANI NË CEREMONINË PËRKUJTIMORE TË 80- VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË AUSHVICIT

Në Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, z. Igli Hasani ka marrë pjesë në ceremoninë e 80-vjetorit të Çlirimit të kampit të përqendrimit Aushvic në Poloni. Në këtë aktivitet, krerë delegacionesh nga e gjitha bota bënë homazhe për viktimat e horrorit të paimagjinueshëm nazist dhe dëgjuan gjithashtu dëshmitë rrëqethëse të disa prej të mbijetuarve të Holokaustit. Ministri Hasani u shpreh rreth krenarisë për Shqipërinë, e cila tregoi një solidaritet të pashembullt në mbrojtje të hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Sipas tij, trashëgimia shqiptare e vetëmohimit do të na frymëzojë gjithmonë për të luftuar në anën e drejtë të historisë.



## ROMË, KRYEMINISTRI RAMA MERR PJESË NË EVENTIN PREZANTUES TË "GIRO D'ITALIA"

Romë, Kryeministri Edi Rama mori pjesë në eventin dedikuar, "Giro d'Italia" një prej aktiviteteve më të famshme sportive në botë, ku Shqipëria u përzgjodh mes shumë kandidatëve për të bërë "La Grande Partenza 2025" – "Nisjen e Madhe 2025", e cilado të transmetohet drejtpërdrejtë në mbi 200 televizione të botës. Gara e famshme popullore, me një traditë 114 vjeçare, do të mbledhë në maj të këtij viti çiklistët më të mirë të botës në Tiranë, Durrës dhe Vlorë dhe do të ndiqet nga qindra milionë teleshikues.



## ZËVENDËSMINISTRJA MEGI FINO, TAKIM ME SEKRETARIN E PËRHERSHËM TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME, EVROPIANE DHE TREGTISË SË MALTËS

Zëvendësministrja për Evropën dhe Punët e Jashtme, znj. Megi Fino ka zhvilluar një vizitë zyrtare në Maltë, ku është takuar me Sekretarin e Përhershëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Evropiane dhe Tregtisë së Maltës, z. Christopher Cutajar. Gjatë takimit është diskutuar rreth marrëdhënieve dypalëshe mes vendeve tona dhe veçanërisht mbi bashkëpunimin në kuadër të integrimit të Shqipërisë në BE. Bashkëbisedimi ka përfshirë ndër të tjera edhe ndërveprimin e dy vendeve tona në organizata ndërkombëtare, duke pasur parasysh mandatin e Shqipërisë në Këshillin e të Drejtave të Njeriut të OKB-së dhe kryesimin e ardhshëm të Maltës të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës gjatë 2025. Gjithashtu, është trajtuar edhe mundësia për të zgjeruar shkëmbimet në fusha të tjera me interes të ndërsjellë.



## MEPJ ORGANIZON AKTIVITETIN TRADICIONAL PËR DITËN E KUJTESËS SË HOLOKAUSTIT

Nën emërtimin "Ndërtimi i një të ardhmeje tolerance", aktiviteti u konceptua si një panel i hapur diskutimesh në praninë e trupit diplomatik, deputetëve, akademikëve, ekspertëve, nxënësve të shkollave etj., me qëllim kryesor për të përkujtuar dhe për të nxjerrë mësime nga një prej kapitujve më të errët të historisë njerëzore: Holokaustin. Në fjalën e tij përshëndetëse, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme z. Igli Hasani e vlerësoi këtë aktivitet si një moment thirrjeje për të riafirmuar përkushtimin e palëkundur të Shqipërisë ndaj humanizmit dhe drejtësisë, për të mbajtur të gjallë kujtimin e atyre që vuajtën dhe për të vazhduar me vendosmëri betejën për një botë ku urrejtja dhe diskriminimi të mos kenë vend, në përpjekje për të ndërtuar së bashku një të ardhme të mirë njerëzore të bazuar në tolerancë.



## TAKIME PRODUKTIVE ME PARTNERË KYÇ, NË LIDHJE ME RRUGËTIMIN EVROPIAN TË SHQIPËRISË DHE BASHKËPUNIMIN RAJONAL

Ministri Igli Hasani është takuar me z. Andreas Schieder, Raportues për Shqipërinë në Parlamentin Evropian, me të cilin ka bashkëbiseduar për punën në hapjen e të gjithë grup-kapitujve të negociatave brenda vitit 2025 dhe mbylljes së procesit deri në vitin 2027. Gjithashtu, z. Hasani ka takuar z. Hugues Moret, të Dërguarin e Posaçëm të Francës për Komunitetin Politik Evropian (EPC), si dhe Victoria Billing, Drejtoreshë për Evropën në Zyrën e Shtetit për Punët e Jashtme dhe Zhvillimin e Komonuelthit (FCDO). Diskutimet janë fokusuar në përgatitjet e Samitit të 6-të të EPC që do të mbahet në Tiranë më 16 maj 2025, si dhe ambicien për ta shndërruar Samitin në një platformë të rezultateve të prekshme për një Evropë të qëndrueshme dhe kohezive.